

Tiranë më: 11.01.2018

STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ALPHA SOFT” SH.P.K

NENI 1 FORMIMI

Në bazë të Ligjit 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" si dhe Ligji 9723 dt 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit" hartohet ky statut për rregullimin normativ të funksionimit të shoqërisë tregëtare.

NENI 2 EMËRTIMI SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë në bazë të këtij statuti dhe do të ketë emërimin "ALPHA SOFT" sh.p.k. Do të ushtrojë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë në bazë të rregjistrimit në institucionin përkatës.

Selia e shoqërisë me Përgjegjesi të Kufizuar "ALPHA SOFT" sh.p.k është: Autostrada Tiranë-Durrës Km 0, Qendra Tregtare "Terminal Center", Kati i I, Kashar-Tiranë. Shoqëria ka të drejtë të hapë filiale në të gjithë vendin.

NENI 3 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjesi të kufizuar "ALPHA SOFT" sh.p.k është pa afat. Me vendim të asamblesë së ortakëve, kohëzgjatja e aktivitetit mund të zgjatet, ose të shkurtohet, të ndërpritet tërësisht ose menjëherë.



NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë "Alpha Soft" sh.p.k është:

- 1- Shitje dhe prodhim programesh (softwaresh) dhe shërbimesh informatike, konsulencë dhe trajnime.
- 2- Agjensi punësimi, rekrutim, trajnim, i burimeve njerëzore. Organizim i praktikave të punës, punësimi stafit për palët e treta.
- 3- Agjensi publicitare në fushën e reklamave, punimeve grafike.
- 4- Agjensi marketingu, konsulencë biznesi, marketing dixhital online.
- 5- Shërbime të ndryshme, në favor të të tretëve, si konsulenca, shërbime në fushën administrative, kontrollit sasior dhe cilësor të mallrave.
- 6- Instalime elektrike, impiante elektronike, impiante industriale, montim dhe asistencë të makinerive me kontroll numerik dhe të automatizimit.
- 7- Spedicion të mallrave të import - eksportit, tranzite në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- 8- Import-eksport, tregtimi i mallrave të ndryshëm, lëndë të para, materiale elektrike, makineri e pjesë këmbimi të të gjitha llojeve, pajisje elektrike, pajisje kompjuterike, pajisje elektronike.
- 9- Shoqëria përveç sa me sipër, mund të shesë, të blejë, dhe të marrë pjesë në formën e aksioneve ose jo edhe në të tjera shoqëri vendase ose të huaja, të cilat kanë objekt të njëjtë veprimtarie ose të ngjashme me të.
- 10- Shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet mbi pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme. Përfshirë këtu ato financiare, tregëtare, shërbimit të vlerësimit të pasurive (të luajtshme dhe të paluajtshme) të lidhë kontrata të dyanshme aktivi dhe pasivi me institutet e kreditit të autorizuar nga ligji dhe me shoqëritë dhe firmat private, të japë garanci reale edhe për të tretët dhe gjithçka që është e nevojshme për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë.
- 11- Administrim në fushën hotelerie të restoranteve dhe bareve, përfshirë këtu dhe hapjen e tyre në të gjithë territorin e Shqipërisë.
- 12- Dhënie me qira të tretëve, makineri, pajisje, mjete transporti etj.
- 13- Konsulenca të ndryshme biznesi, studime të ndryshme, trajnime të ndryshme, dhe shërbime të tjera.
- 14- Organizime të praktikave profesionale dhe mësimore.
- 15- Tregtimin e të gjithë artikujve të mësipërm me shumicë e pakicë, për llogari të vetë shoqërisë si dhe për llogari të tretëve.



NENI 5

Shoqëria mund të ndryshojë emertimin, selinë, objektin e veprimtarisë së saj me Vendim të Asmblesë së Ortakëve.

NENI 6

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali fillestar i shoqërisë "Alpha Soft" sh.p.k është 100.000 lekë i përbërë në 3 kuota Kapitali i shoqërisë është nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga ortakët e shoqërisë përkatësisht:

1. Z.Eridon Hysendhima zotërues i një koute me vlerë nominale në masën 60.000 lekë, e cila përfaqëson 60% të kapitalit të shoqërisë.
2. Z. Dorjan Brinja zotërues i një koute me vlerë nominale në masën 30.000 lekë, e cila përfaqëson 30% të kapitalit të shoqërisë.
3. Znj. Dinejda Hysendhima zotëruese e një koute me vlerë nominale në masën 10.000 lekë, e cila përfaqëson 10% të kapitalit të shoqërisë.

1. Eridon Hysendhima, shtetas shqiptar, i biri i Sezaiut, i datëlindjes 12-10-1984, lindur në Orikum-Vlorë, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letëmjoftimit me Nr.: 031216342.
2. Dorjan Brinja, shtetas shqiptar, i biri i Bashkimit, i datëlindjes 22-06-1982, lindur në Vlorë, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letëmjoftimit me Nr.: 028551543.
3. Dinejda Hysendhima shtetase shqiptare, e bija e Bashkimit, e datëlindjes 06-03-1986, lindur në Vlorë, banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e letëmjoftimit me Nr.: 031430460.

Kapitali fillestar është i nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga ortakët themelues, ai mund të ndryshojë sipas vendimit që mund të marrin ortakët, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

NENI 7

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar për efekt vlefshmërie duhet të bëhet me Akt Noterial dhe të rregjistrohet si në librin e shoqërisë ashtu dhe në Zyrën e Rregjistrimit Tregëtar.

NENI 8

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

NENI 9

Transferimi i pajisjeve të kapitalit themeltar tek të tretët, jo ortakë, duhet të miratohet nga asambleja e ortakëve.

NENI 10

Shoqëria ka të drejtë të lerë peng një pjesë të kapitalit të saj themeltar në rast shitje të detyruar të pjesëve të lëna peng, pengmarrësi do të pranohet si person të cilit i janë transferuar pjesë të kapitalit, me përjashtim të rastit kur shoqëria preferon ti blejë ato dhe të deklarojë zvogëlimin e mundshëm të kapitalit themeltar.

NENI 11 STRUKTURA E SHOQËRISË

Asambleja e ortakëve është Organi suprem i shoqërisë. Ajo përbëhet nga ortakët me të drejtë vote në mbledhjen përkatëse.

Asambleja funksionon sipas përcaktimeve të bëra në këtë statut dhe dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 12

Vendimet e asmblesë se ortakëve, në përputhje me ligjin, dhe normat e këtij statuti janë të detyrueshem për të gjithë. Ato regjistrohen në librin e shoqërisë.

NENI 13

Çdo i interesuar mund të kërkojë në gjykatë anulimin e vendimit të Asamblesë së Shoqërisë të marrë në kundërshtim me ligjin apo normat e këtij statuti.

NENI 14

Aktiviteti financiar i shoqërisë kontrollohet nga Ekspertët kontabël të emëruar.

NENI 15 ASAMBLEJA E SHOQËRISË VENDIMARRJA

Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë. Ajo mbledhet në seancë të zakonshme të paktën çdo vit.



NENI 16

Mbledhja e zakonshme e asamblesë drejtohet me rotacion nga ortakët, ose nga personi i autorizuar prej tyre me vendim të asamblesë.

NENI 17

Në mbledhjen e asamblesë mund të marrin pjesë Administratori, kur ky është i jashtëm, pra nuk është ortak në shoqëri, ekspertët kontabël të autorizuar, pa të drejtë vote.

NENI 18

Mbledhja e asamblesë njoftohet me shkrim ose postë elektronike jo më pak se 15 ditë përpara, ku duhet të përmbajë kohën/datën/orën/vendin dhe rendin e ditës. Këto shënohen në librin e shoqërisë.

NENI 19

Njëri nga ortakët mund të kërkojë shtyrjen e datës së mbledhjes, por kjo nuk mund të aplikohet më shumë se njëherë.


NENI 20

Për marrjen e vendimeve në mbledhjen e asamblesë pesha e votës dhe vendimeve përcaktohet nga kapitali themeltar i ortakëve votues apo përfaqesues të tij. Përcaktues është vota e ortakut që ka kapital më shumë.

NENI 21

Asambleja e ortakëve vendos për:

- Ndryshimin e dispozitave të statutit.
- Emërimin e administratorit dhe shkarkimin e tij.
- Miratimin e rregullores së brendshme të shoqërisë ose ndryshimin e dispozitave të saj.
- Prishjen e parakohshme të shoqërisë.
- Ndryshimin e kapitalit themeltar.
- Vendimet që përcaktojnë politikën e drejtimit të shoqërisë.
- Emërim apo shkarkim të administratorëve të filialeve të shoqërisë.
- Miratimin ose mospranimin e propozimeve të administratorit për kushtet e kontrates së punës për personelin e shoqërisë.
- Miratimin e raportit vjetor të administrimit të shoqërisë.
- Miratimin e marrëveshjeve apo investimeve.
- Miratimin e strukturës së shoqërisë dhe ndryshimet e saj.



NENI 22
DREJTIM DHE ADMINISTRIM

Për drejtimin e shoqërisë ortakët emërojnë Administratorin. Administratori mund të jetë një nga ortakët ose një person tjetër i zgjedhur nga ortakët. Kur është i jashtëm përcaktohen dhe kushtet e punës nëpërmjet kontratës së punës. Administratori zgjidhet për një periudhë 5 vjecare.

NENI 23

Shoqëria "Alpha Soft" sh.p.k ka vulën e saj.

NENI 24

Emri i shoqërisë, administratorit si dhe vula e shoqërisë duhet të figurojnë në të gjitha shkresat zyrtare të shoqërisë si dhe dokumenta që kanë të bëjnë me përmbushjen e objektit, apo që i shërbejnë ushtrimit të aktivitetit të saj.

NENI 25

Administratori përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, duke zbatuar politikën e drejtimit të shoqërisë. Në raste të veçanta mund edhe të caktojë një njeri tjetër me prokurë të posaçme ose dhe një prej ortakëve.

NENI 26

Administratori mban përgjegjësi për shkelje të ligjit, statutit, rregullores së brendëshme para asamblesë, të tretëve dhe instancave ligjore.

NENI 27

Në fund të çdo viti administratori përgatit raportin vjetor të administrimit dhe ja paraqit Asamblesë së ortakëve së bashku me inventarët dhe llogaritë vjetore.



NENI 28

Administrator është Z.Dorjan Brinja për periudhën 11.01.2018 - 10.01.2023

Administratori ka këto kompetenca:

- Përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët.
- Drejton aktivitetin e shoqërisë mbi bazë të objektit të saj.
- Punësimin e personelit të shoqërisë.
- Përcaktimin e saksioneve të kushteve të kontratës të punës për personelin.
- Thirrjen e mbledhjes së zakonshme.
- Hartimin e paraqitjen e raportit vjetor.

NENI 29

Shoqëria nuk merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet apo veprime juridikë të administratorit, kur këto nuk janë përmbajtur objektit të veprimtarisë së shoqërisë, ose nuk janë në qëllim të përmbushjes së objektit.

NENI 30

Përderisa "rezerva e domosdoshmërisë" të arrijë 1/10 pjesë të kapitalit themeltar shoqëria është e detyruar të depozitohet 1/20 e fitimit të realizuar.

NENI 31

Fitimet, pasi të jenë depozituar shumat e urdhëruara për rezervën e të tjera, i takojnë ortakëve të shoqërisë.

NENI 32

Bilanci vjetor duhet të paraqitet në organet tatimore, pasi miratohet nga asambleja, brenda datës 31.03. të vitit pasardhës.

NENI 33

Në rast të likuidimit të Shoqërisë, caktohet likuidatori, duke qenë i detyruar të njoftojë për punët e shoqërisë.



NENI 34
MARRËDHËNIET E PUNËS

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nepërmjet dispozitave të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Të gjithë personat e punësuar në shoqëri kanë të drejtë të përcaktojnë marrëdhëniet e punës nepërmjet Kontratës së Punës dhe Kontratës Kolektive të Punës.

NENI 35

Mosmarrëveshjet e punës zgjidhen nga Gjykata e Rrethit, kur mjetet e tjera nuk japin rezultat. Shoqëria respekton rregullat e punësimit dhe të sigurimeve shoqërore, ndërsa të punësuarit janë të detyruar që ti pranojnë e respektojnë ato. Të gjithë të punësuarit janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin dhe sekretin profesional.

NENI 36

Asambleja e shoqërisë përcakton përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, organet gjyqësore, caktimin e avokatit si dhe në marrëdhënie me sistemin fiskal dhe organet e tjera shtetërore.

NENI 37

Gjithë veprimtaria e shoqërisë në aspektin ekonomik drejtohet nga administratori i shoqërisë. Pjesëmarrje në shoqëri të tjera, ndryshim statusi, kapitali themelor, miratim bilanci, pranim ortakë të rinj përcaktohet nga Asambleja e shoqërisë.

NENI 38
MBARIMI SHOQËRISË

Veprimtaria e shoqërisë mbaron me vendim të asamblesë së shoqërisë në rastet e parashikuara në ligj.

NENI 39
LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Likujdimi i shoqërisë do të bëhet sipas dispozitave të Legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në çastin e likujdimit.

Kur shoqëria kalon në procedurën e likujdimit Asambleja cakton komisionin e likujdimit të cilit i paraqet pasqyrat e bilancit të likujdimit dhe shoqëria mbyll aktivitetin e saj në momentin kur ky bilanc aprovohet.

Pasuria e shoqërisë, pasi shlyen detyrimet e shoqërisë i kalojnë ortakëve të shoqërisë, sipas kapitalit themeltar.



NENI 40

Likuidimi i shoqërisë vendoset me vendim të Asamblesë së shoqërisë i cili për të kryer veprimet që kërkohen emëron një likuidator me tagrat e përcaktuara në ligjin 9901 dt 14.04.2008 “Për shoqëritë tregëtare”. Likuidatori është përgjegjës si ndaj shoqërisë dhe ndaj të tretëve. Ai shpërblehet në bazë të vendimit të asamblesë të shoqërisë.

NENI 41

Likuidatori i emëruar përfaqëson shoqërinë dhe nënshkruan duke vendosur firmën nën vulën e shoqërisë. Ai duhet të përfundojë shitjet që janë të disponueshme për llogari të shoqërisë, të marra nga çdo debitor, llogari të sakta në monedhë dhe të kthejë pasurinë e shoqërisë në para. Për çështjet e mbetura pezull vendos asambleja e shoqërisë për zgjedhjen e tyre. Në përfundim të likuidimit të shoqërisë likuidatori përpilon bilancin përfundimtar dhe të nxjerrë buletinin përkatës.

NENI 42

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME


Përsa nuk është shprehur në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit 9901 dt.14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” si dhe të ligjit 9723 dt 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit” si dhe çdo dispozitë të Legjislacionit Shqiptar që gjen vend në keto marrëdhënie Juridike Tregëtare.

NENI 43


Shoqëria fiton personalitet juridik nga dita e rregjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

ORTAKËT

Eridon Hysendhima



Dinejda Hysendhima



Dorjan Brinja

